




|                                                                                   |                      |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO                       |                      |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY |                      |
| Dep. 2-D / DPK                                                                    | Nr. Prot. 01-2613/14 |
| Dep. 02                                                                           | Br. Prot. Prot No.   |
| Nr. i faq. 02                                                                     | Data 11-07-2014      |
| Broj stranica                                                                     | Datum                |
| Nr. pages                                                                         | Date                 |
| PRISHTINE                                                                         |                      |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.07.2014, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-1997/14, për z. Gani Dreshaj, Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, për shkak se nuk ushtron më funksion publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Gani Dreshaj, Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Dreshaj është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë me ç'rast është kuptuar se tashmë zyrtari i lartë z. Dreshaj nuk e ushtron me funksionin e Anëtarit të Kuvendit Komunal në Istog, dhe po ashtu nuk ka asnjë funksion tjetër publik.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, zyrtari i lartë z. Dreshaj pas dorëheqjes nga funksioni publik mund të ushtroj pozitën e personit të autorizuar në bizneset private, Sh.P.K "Getrinke - Vrella", Sh.P.K. "Cash Point Invest", Kosova Invest A.G.Sh.A, Sh.P.K. "Macrometal Kosova" N.P.T "Teuta e re", Sh.P.K N.Sh.T. "G & M" Sh.P.K. Prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

